



Nr. _____ prot.

Korçë, më ____ .09.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT(paraparak)

Date **02.09.2024**

Drejtuar: **Shoqërise “ARTEO 2018” shpk, adresa :** Elbasan Lagjja Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303.

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës **REF-16250-08-14-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **Blerje automjete (Minieskavatorë me goma)**

Afati: **30 ditë kalendarike nga data e lidhjes të kontratës.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : **Date 19.08.2024, Nr.51**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria “ ARTEO 2018 ” shpk, NIPT L82523203F me vlerën:

7.795.000 (shtate milion e shtateqind e nentedhete e pese mije) lekë, pa tvsh.

2. Shoqëria “ TechnoLux” sh.p.k, NIPT L61415029I me vlerën:

8.290.000 (tete milion e dyqind e nentedhete mije) lekë, pa tvsh.

3. Subjekti “ ANDI HAMO ” p.f, NIPT K76926201W me vlerën:

8.500.000 (tete milion e peseqind mije) lekë, pa tvsh.

4. Shoqeria “ UNITRACK ALBANIA” sh.p.k, NIPT K51507024V me vlerën:

8.680.000 (tete milion e gjashteqind e tetedhete miije) lekë, pa tvsh.

5. Shoqeria “ Anadea ” sh.p.k, NIPT L87201401H me vlerën:

8.700.000 (tete milion e shtateqind miije)

Nga pjesërmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Subjekti “ ANDI HAMO ” p.f,NIPT K76926201W, per arsye se:

Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,Kriteret e pergjithshme të kualifikimit pika 1.Ç ku percaktohet shpreshimisht se : “Ofertuesi deklaron se:

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së” dhe kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 1.a, per arsye se ne formularin e vetdeklarimit sipas shtojces 8, ne piken A-DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT, nuk jane shenuar personi/personat ne cilesine e anetarit te organit administrativ,drejtorit ose mbikeqyresit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, per te cilet ofertuesi duhet te deklaronte se nuk jane te denuar sipas parashikimeve te nenit 76 te LPP.

Pra nuk eshte bere plotesimi i kesaj shtojce sipas kerkesave te saj nga ofertuesi si rrjedhim autoriteti kontraktor nuk mund te beje verifikimet per gjendjen gjyqesore sipas parashikimeve te shkreses te perbashket te APP Nr 1155 Prot dhe Ministrisë të Drejtësisë Nr 1001/1Prot datë 01.02.2019 .

2. Shoqeria “ UNITRACK ALBANIA” sh.p.k, NIPT K51507024V, per arsye se:

1.“Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.2.1. ku përcaktohet se : “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate “

Konkretisht,për plotësimin e kriterit të mësipërm ofertuesi ka dorëzuar një faturë tatimore shitje per shitjen e mallit Kove 95 cm me vlere 61944 lek,pa tvsh.

Për sa më siër objekti i faturës nuk është i ngjashëm me objektin që prokurohet dhe vlera është më e vogël se vlera e kërkuar.

3. Shoqeria “ Anadea ” sh.p.k, NIPT L87201401H , per arsye se:

1.Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,Kriteret e pergjithshme të kualifikimit pika 1.Ç ku percaktohet shpreshimisht se : “Ofertuesi deklaron se:

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së” dhe kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 1.a, per arsye se ne formularin e vetdeklarimit sipas shtojces 8, ne piken A-DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT, nuk jane shenuar personi/personat ne cilesine e anetarit te organit

administrativ, drejtorit ose mbikeqyresit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, për të cilët ofertuesi duhet të deklaronë se nuk janë të denuar sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP.

Pra nuk është bërë plotësimi i kësaj shtojce sipas kërkesave të saj nga ofertuesi si rrjedhim autoriteti kontraktor nuk mund të bëjë verifikimet për gjendjen gjyqësore sipas parashikimeve të shkresës të përbashkët të APP Nr 1155 Prot dhe Ministrisë të Drejtësisë Nr 1001/1 Prot datë 01.02.2019 .

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ***Shoqërinë "ARTEO 2018 " sh.p.k,*** me adresë: Elbasan Lagjja Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej ***7.795.000 (shtatë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë, pa tvsh,*** është identifikuar si ofertë fituese (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**